

PËRSHKRIMI

CureTech 1001, bazë akrilike e cila parandalon avullimin e ujit, e aplikuar në betonin e derdhur të njomë, duke mbajtur ujin brenda betonit me shtresën e formuar nga CureTech 1001 zvogëlon tkurrjen duke parandaluar tharjen e shpejtë.

FUSHA E APLIKIMIT

- Kurimi i elementeve strukturorë vertikale dhe horizontale.
- Aplikime për forcimin e sipërfaqes.
- Në betonet e aeroportit dhe tereneve.
- Betonime të kanaleve.
- Përdoret në betonime ku lagështia është e ulët dhe temperaturat janë të larta.

KARAKTERISTIKAT

- Redukton çarjet e tkurrjes të shkaktuara nga tharja e shpejtë e sipërfaqes.
- Mundëson sipërfaqe më të fortë.
- Aplikohet për të fituar një shkëlqim në sipërfaqet e betonimeve në teren, në rrugë dhe në dysheme.
- Jo i ndezshëm dhe i lehtë për t'u përdorur.
- Siguron një zgjidhje më efektive dhe më të efektshme në krahasim me metodat e kurimit siç janë ujitjen me thasë ose spërkatje direkt në sipërfaqen e betonit.
- Rezistent ndaj rrezeve UV, që pasqyrojnë rrezet e diellit dhe zvogëlojnë rrezikun e humbjes së ujit në beton të njomë.
- Përdoret veçanërisht në betonimet në terren.

PËRDORIMI

- Duhet të aplikohet në mënyrë homogjene me anë të spërkatjes ose me rul në betonin e sapo përfunduar.
 - Duhet të përzihet mirë përpara aplikimit.
- Koha e tharjes së materialit pas kurimit është 1-2 orë në 20 ° C.

SASIA E PËRDORIMIT (m²)

Në varësi prej absorbimit të sipërfaqes së betonit dhe temperaturës së ambientit;

Aplikime furçe, rul 0,100 - 0,250 kg
Aplikime spërkatje 0.150 - 0,250 kg

KUSHTET E RUAJTJES DHE PAKETIMI

Kur ruhet në paketën e tij origjinale në ambiente të thata, të mbrojtura dhe të ajrosura nga + 5 ° C / + 25 ° C duke u mbrojtur nga ngrirja dhe rrezet e diellit, jetgjatësia e saj është më shumë se 1 vit.

Shitet në sasi prej 1100kg

INFORMACION MBI SIGURINË

Kontaktet e lëkurës dhe syve me aditivin duhet të parandalohen, në rast kontakti lani me shumë ujë. Në rast të kontaktit me sytë, shpërlajeni menjëherë me shumë ujë dhe kërkoni këshilla mjekësore. Për informacion të mëtejshëm ju lutemi referojuni fletës së të dhënave për sigurinë e materialit (MSDS) të produktit.